



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori k. Salih Mustafës

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rishikim ose leje
për apelim**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit për të akuzuarin
Julius von Bone

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 39(3) dhe 41(5) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 77 dhe 79 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 9 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin Kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse” (“Vendimi i Kontestuar”), në të cilin ai, ndër të tjera e urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të paraqiste tabela për nxjerrjen e materialeve së bashku me çdo paketë të provave inkriminuese që do të nxirren në të ardhmen, që mbulohen nga rregulla 102(1)(b) e Rregullores, si dhe tabelën përmbledhëse të nxjerrjes së materialeve në fund të fazës së procedurës paraprake.² E njëjta gjë vlen për Mbrojtjen, nëse ajo vendos që të nxjerrë prova.³

2. Më 19 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti “Kërkesën për rishikim të urdhrit për paraqitjen e tabelave të nxjerrjes së materialeve ose, si alternativë, për leje për të apeluar këtë urdhër” (“Kërkesa”),⁴ ku ZPS-ja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të: (i) rishikojë urdhrin për paraqitjen e tabelave për nxjerrje të materialeve (“Kërkesa për rishikim”); ose (ii) të autorizojë lejen për të apeluar urdhrin në fjalë (“Kërkesa për leje”); (iii) të miratojë efektin pezullues të urdhrit në fjalë deri në zgjidhjen përfundimtare të kërkesës apo të ndonjë apelimi (“Kërkesa për efekt pezullues”); dhe (iv) t’i japë ZPS-së mundësinë që të bëjë parashtime pas zgjidhjes përfundimtare të

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi Kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse*, 9 tetor 2020, publik, para 71, 90(m).

³ Vendimi i Kontestuar, para. 90(n).

⁴ KSC-BC-2020-05, F00037, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për rishikim të urdhrit për paraqitjen e tabelave të nxjerrjes së materialeve ose, si alternativë, për leje për të apeluar këtë urdhër*, 19 tetor 2020, publik.

kërkesës, ose të çfarëdo apelimi, në lidhje me afatet dhe kushtet në Vendimin e Kontestuar që mund të ndikohen prej tyre (“Kërkesa për parashtrime”).⁵

3. Në të njëjtën ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi urdhër për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes gjyqësore në lidhje me nxjerrjen e materialeve, të mërkurën, 28 tetor 2020, në orën 15:00.⁶

4. Më 23 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shkurtoi afatet për përgjigjen e Mbrojtjes ndaj kërkesës dhe për kundërpërgjigjen e ZPS-së, nëse do të kishte.⁷

5. Më 28 tetor 2020, u mbajt konferenca për ecurinë e çështjes gjyqësore (“konferencë për ecurinë e çështjes gjyqësore”),⁸ ku Mbrojtja e dha përgjigjen e saj⁹ dhe ZPS-ja kundërpërgjigjen.¹⁰ Pas parashtrimeve të palëve në lidhje me kërkesën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një urdhër me gojë, sipas të cilit ZPS-ja do të parashtrojë, deri të mërkurën, 4 nëntor 2020, një propozim të përbashkët për tabelën e nxjerrjes së materialeve pas konsultimit me Mbrojtjen (“Urdhri me gojë”).¹¹

6. Më 4 nëntor 2020, në përputhje me urdhrin me gojë, ZPS-ja dorëzoi “Parashtrimin e përbashkët të tabelës së kategorizimit sipas rregullës 109(c)” (“Parashtrimi i përbashkët”).¹²

⁵ Kërkesë, para. 20.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00039, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së seancës për vetëdeklarim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe të konferencës së dytë për ecurinë e çështjes*, 19 tetor 2020, publik, para 19, 22(a).

⁷ KSC-BC-2020-05, F00044, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për shkurtimin e afateve*, 23 tetor 2020, publik, para. 9.

⁸ KSC-BC-2020-05, Transkript, 28 tetor 2020 (“Transkript i datës 28 tetor 2020”), publik.

⁹ 28 tetor 2020 Transkript, f. 62, rreshti 10 to f. 65, rreshti 2.

¹⁰ 28 tetor 2020 Transkript, f. 65, rreshti 16 to f. 69, rreshti 18.

¹¹ 28 tetor 2020 Transkript, f. 74, rreshti 21 to f. 75, rreshti 2.

¹² KSC-BC-2020-05, F00045, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i përbashkët i tabelës së kategorizimit sipas rregullës 109(c)*, 4 nëntor 2020, publik me një shtojcë (“tabela e propozuar”), publik.

II. PARASHTRIMET E PALËVE

7. Sa i përket kërkesës për rishikim, ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) nuk iu dha mundësi palëve që të bënin parashtrime për domosdoshmërinë e tabelave të nxjerrjes së materialeve;¹³ (ii) nuk e mori parasysh në masë të mjaftueshme kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara (“DHS”);¹⁴ dhe (iii) nuk balancoi dobritë e mundshme të urdhrit për parashtrimin e tabelave të nxjerrjes së materialeve kundrejt ndikimit të këtij urdhri në përgatitjen e palëve dhe në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.¹⁵ Rrjedhimisht, ZPS-ja argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar gjatë ushtrimit të kompetencës së brendaqenësishme të tij sipas nenit 39 të Ligjit dhe rregullës 95(2)(b) të Rregullores dhe rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë.¹⁶

8. Si alternativë, për të njëjtat arsye, ZPS-ja argumenton se gjithashtu janë plotësuar kushtet për leje për të apeluar sipas rregullës 77(2) të Rregullores.¹⁷ Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kontestuar në lidhje me aspektin se a e ka tejkaluar Gjykatësi i Procedurës Paraprake kompetencën e tij sipas nenit 39 të Ligjit dhe rregullës 95(2)(b) të Rregullores kur e ngarkoi ZPS-në me detyrën e paraqitjes së tabelave.¹⁸

9. Në konferencën për ecurinë e çështjes gjyqësore, Mbrojtja deklaroi se palët duhet të lejohen të bëjnë parashtrime në lidhje me çfarëdo urdhri që vë ngarkesë të caktuar mbi njërin ose të dy palët.¹⁹ Për hir të praktikitetit dhe të shmangies së përsëritjes së të njëjtës punë, Mbrojtja propozoi që në konsultim me ZPS-në, të përpilohej një tabelë për nxjerrjen e materialeve që do të plotësonte kushtet e rregullës 109(c) të Rregullores

¹³ Kërkesa, para 4-6.

¹⁴ Kërkesa, para 4, 7-12.

¹⁵ Kërkesa, para 4, 13-14.

¹⁶ Kërkesa, para. 2.

¹⁷ Kërkesa, para 2, 15-17.

¹⁸ Kërkesa, para. 15.

¹⁹ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 63, rreshti 23 deri në f. 64, rreshti 1.

dhe pritshmëritë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.²⁰ Me propozimin e një tabele të tillë, Mbrojtja sugjeroi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ta përshtaste ose saktësonte urdhrin e mëparshëm përfshirë në Vendimin e Kontestuar, pa e rishikuar domosdoshmërisht sipas rregullës 79 të Rregullores.²¹

10. Në konferencën për ecurinë e çështjes gjyqësore, ZPS-ja nuk e kundërshtoi idenë e tabelës për nxjerrjen e materialeve, sikurse është paraparë në Vendimin e Kontestuar e as dobishmërinë e saj, por shprehu mendimin se përgatitja e saj kërkonte kohë dhe kapacitete, gjë që do të kishte ndikim në kryerjen e shpejtë të procedimit në çështjen aktuale.²² Konkretisht, ZPS-ja parashtrroi se rregulla 109(c) e Rregullores kërkon kategorizimin e provave “aq sa është e realizueshme”, që mund të ndryshojë nga çështja në çështje.²³ ZPS-ja pretendoi se “e realizueshme” sipas rregullës 109(c) të Rregullores nënkupton “e drejtë dhe proporcionale dhe çfarë mund të bëhet në mënyrë të arsyeshme me kapacitetet në dispozicion, në përputhje me kornizën tërësore të nxjerrjes së materialeve dhe pa komprometuar shpejtësinë e procedimit”.²⁴ Duke pasur parasysh kapacitetet aktualisht në dispozicion dhe kohën që kërkohet për të përpiluar tabelat e kërkuara, nëse urdhri për të përpiluar tabelat e nxjerrjes së materialeve qëndron ashtu siç është, ZPS-ja parashikon që do t’i duhet të kërkojë më shumë se një muaj shtyrje, me efekt të mëtejme për afatet e tjera për nxjerrjen e materialeve në këtë çështje.²⁵ Për këto arsye, ZPS-ja pajtohet me Mbrojtjen që të përpilohet një tabelë që të plotësonte kushtet e Rregullores dhe t’i paraqitet Gjykatësit të Procedurës Paraprake për miratim.²⁶

11. Në parashtrimin e përbashkët, pas konsultimit me Mbrojtjen, ZPS-ja pohon se tabela e propozuar i plotëson kushtet e kategorizimit sipas rregullës 109(c) të

²⁰ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 64, rreshtat 14-19.

²¹ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 64, rreshtat 22-25.

²² Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 73, rreshti 22 deri në f. 74, rreshti 1.

²³ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 66, rreshtat 8-17.

²⁴ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 67, rreshtat 2-5.

²⁵ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 68, rreshtat 10-23.

²⁶ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 69, rreshtat 12-15.

Rregullores dhe do të paraqitet brenda një jave pas parashtrimit të dosjes paraprake të ZPS-së, duke pasur parasysh se ky kategorizim do të nxirrej nga analiza në Dosjen Paraprake.²⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Në përputhje me rregullën 79 të Rregullores, në rrethana të veçanta dhe kur është vërtetuar se një arsyetim është qartësisht i gabuar, një panel mund t'i rishikojë vendimet e veta. Kërkesa për rishikim nuk i pezullon afatet e mjeteve juridike.

13. Në përputhje me nenin 45 të Ligjit dhe rregullën 77 të Rregullores, leja për apelim miratohet nëse vendimi i kontestuar lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

IV. DISKUTIM

A. KËRKESA PËR RISHIKIM

14. Rishikimi është një masë e jashtëzakonshme dhe duhet të ndërmerret vetëm kur është vërtetuar se një arsyetim është qartësisht i gabuar, apo kur është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë. Faktet dhe argumentet e reja që dalin pas dhënies së vendimit të kontestuar mund të jenë relevante për këtë vlerësim.²⁸

²⁷ Parashtrimi i Përbashkët, para 2, 4.

²⁸ *Ngjashëm*, për shembull ICC, *Prosecutor v Dominic Ongwen*, ICC-02/04-01/15-468, Trial Chamber IX, Decision on Request for Reconsideration of the Order to Disclosure Requests for Assistance, 15 June 2016, para. 4; *Prosecutor v Jean-Pierre Bemba Gombo et al*, ICC-01/05-01/13-1085, Trial Chamber VII, Decision on Kilolo Defence Request for Reconsideration, 15 July 2015, para. 4.

15. Në çështjen aktuale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr në konsideratë faktet dhe argumentet e reja relevante që janë dorëzuar pas Vendimit të Kontestuar, konkretisht parashtrimet e palëve gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes gjyqësore, parashtrimin e përbashkët dhe tabelën e propozuar, siç janë pajtuar ZPS-ja dhe Mbrojtja.

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se tabela e propozuar bazohet në kategorizimin individual të çdo prove të nxjerrë, sipas elementëve kontekstualë, krimeve bazë dhe formave të përgjegjesisë penale të parashtruara në aktakuzë.²⁹ Veç kësaj, palët propozojnë që të shënojnë referenca konkrete në secilën provë të nxjerrë, që e orienton palën marrëse te pjesa relevante e provës.³⁰ Është me rëndësi të theksohet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se palët do të përpiqen, aq sa do të jetë e realizueshme, që të kategorizojnë provat e nxjerra sipas elementëve ligjorë të secilit krim dhe formës së përgjegjesisë penale të parashtruar në aktakuzë, dhe sipas datës ose vendndodhjes konkrete, sipas rastit.³¹ Për sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se tabela e propozuar është në përputhje me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin e Kontestuar në lidhje me formatin e tabelës së nxjerrjes së materialeve dhe standardit të kategorizimit që kërkohet prej rregullës 109(c) të Rregullores. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e rishikon këtë aspekt të Vendimit të Kontestuar.

17. Sa i përket afatit për tabelën e propozuar, palët propozojnë që të përgatitet vetëm një tabelë përmbledhëse, brenda një jave pas parashtrimit të dosjes paraprake të ZPS-së dhe, ngjashëm, brenda një jave pas parashtrimit të dosjes paraprake të Mbrojtjes, nëse Mbrojtja vendos të nxjerrë prova. Ky element dallon nga Vendimi i Kontestuar, i cili parasheh një tabelë të nxjerrjes së materialeve për çdo paketë të provave të nxjerra inkriminuese sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, së bashku me tabelën

²⁹ Parashtrim i Përbashkët, para. 2.

³⁰ Parashtrim i Përbashkët, para. 2.

³¹ Parashtrim i Përbashkët, poshtëshënimi 4.

përmbledhëse në fund të fazës së procedurës paraprake.³² Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron, në njërën anë, se përgatitja e Mbrojtjes mund të ndikohet nga mungesa e tabelave të nxjerrjes së materialeve të paraqitura për çdo paketë të materialeve të nxjerra, meqenëse kjo e privon Mbrojtjen nga një udhëzues i dobishëm që shoqëron çdo grumbull të provave gjatë fazës përgatitore. Në anën tjetër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje formulimin elastik në rregullën 109 të Rregullores dhe faktin se Mbrojtja pajtohet me parashtrimin e një table të propozuar të vetme, në momentin e parashtrimit të dosjes paraprake të ZPS-së. I është kushtuar vëmendje gjithashtu edhe faktit se, në çështjen konkrete, vetëm një sasi relativisht e kufizuar e provave do të nxirret sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, dhe se tabela e propozuar përsëri do t'i ofrojë Mbrojtjes një mundësi minimale për analizimin e materialeve, në kohë të mjaftueshme para fillimit të seancave të gjykimit.³³

18. Për sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se mbajtja e mënyrës fillestare të urdhëruar për paraqitjen e tabelave gjatë tërë procesit të nxjerrjes së materialeve përbën padrejtësi sipas kuptimit të rregullës 79(1) dhe konstaton se është veprim i drejtë që të rishikohet Vendimi i Kontestuar sa i përket kohës kur bëhet parashtrimi i tabelës sipas rregullës 109(c). Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton tabelën e propozuar për procedurën e nxjerrjes së materialeve në këtë çështje dhe urdhëron ZPS-në dhe Mbrojtjen, nëse kjo e fundit vendos të nxjerrë prova, që të paraqesin tabelën e propozuar brenda një jave pas parashtrimit të dosjeve paraprake të tyre.

B. KËRKESA PËR LEJE

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se parashtrimi i përbashkët përbën parashtrimin e fundit në lidhje me afatin shtatëditor për vendimin e Gjykatësit të

³² Vendimi i Kontestuar, para 71, 90(m).

³³ Parashtrim i Përbashkët, para. 1 dhe poshtëshënimi 4.

Procedurës Paraprake mbi kërkesën për leje, në pajtim me rregullën 77(3) të Rregullores.

20. Sa i përket rishikimit të Vendimit të Kontestuar për aq sa është saktësuar në paragrafin 18 më lart, kërkesa për leje bëhet e panevojshme, meqenëse ZPS-ja e ka kërkuar atë si alternativë për rishikimin.

C. KËRKESAT LIDHUR ME KËTË ÇËSHTJE

21. Duke pasur parasysh rishikimin e Vendimit të Kontestuar për aq sa është saktësuar në paragrafin 18 më lart, kërkesa për efekt pezullues bëhet e panevojshme.

22. Sa i përket kërkesës për parashtrime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se ZPS-ja tashmë i ka bërë parashtrimet gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes gjyqësore në lidhje me afatet e procesit të nxjerrjes së materialeve.³⁴ Rrjedhimisht, kërkesa për parashtrime është e panevojshme.

³⁴ Transkript i datës 28 tetor 2020, f. 68, rreshtat 4-23.

V. VENDIM

23. Për arsyt e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesën për rishikim për aq sa saktësohet në paragrafin 18 të vendimit aktual;
- b. **MIRATON** tabelën e propozuar për procedurën e nxjerrjes së materialeve në çështjen aktuale.
- c. **URDHËRON** ZPS-në dhe Mbrojtjen, nëse kjo e fundit vendos që të nxjerrë prova, që të parashtrinë tabelën e propozuar brenda një jave pas protokollimit të dosjeve të tyre paraprake;
- d. **HEDH POSHTË** kërkesën për leje;
- e. **HEDH POSHTË** kërkesën për efekt pezullues; dhe
- f. **HEDH POSHTË** kërkesën për parashtrime;

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 5 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.